



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



E K S T R A K T I I P R O C E S V E R B A L I T

të mbledhjes së tretë të Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 02.06.2016, e cila filloi në orën 15:00.

Në mbledhje morën pjesë: Halim Halimi, kryesues i Komitetit, Dardan Sejdiu, nënkryetar i Komunës, Sami Hamiti, shef i GP të LDK-së, Hazir Borovci, përfaqësues i LDK-së, Besa Rafuna, përfaqësuese e LDK-së, Qëndron Kastrati, shef i GP të LVV-së, Hatixhe Hoxha, përfaqësuese e LVV-së Lirak Çelaj, shef i GP të PDK-së, Brahim Mehmetaj, shef i GP të AAK-së dhe Mirlinda Sopi shefe e GP të AKR-së.

Munguan: Laura Zherka, përfaqësuese e PDK-së.

Të pranishëm ishin edhe: Agim Salihu, këshilltar i kryesuesit të Kuvendit të Komunës, Ardian Olluri, shef i Zyrës ligjore, Osman Bllaca, këshilltar i Kryetarit, Ismail Kokaj, drejtor i Drejtorisë së Financave, Genc Bashota, drejtor i Drejtorisë së Planifikimit Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm, përfaqësues të mediave, përfaqësues të KFOR-it dhe OSBE-së. Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Halim Halimi**, kryesues dhe propozoi këtë

REND I DITËS:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016;**
- 3. Raporti tremujor janar - mars 2016;**
- 4. Të ndryshme.**

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Kryesuesi, nga zyrtarët e Shërbimit të Kuvendit kërkoi që mu kujdes gjithmonë për prezencën e anëtarëve të Komitetit për Politikë dhe Financa po ndodhë dikush me qenë në Komitet e mos me qenë i regjistruar e mos mi dalë mëditja. Po ashtu tha edhe herave tjera ju kisha lut të keni kujdes për prezencën e anëtarëve të Komitetit dhe Kuvendit, se bazë për pagesë në financa është nënshkrimi i anëtarëve të Komitetit dhe Kuvendit.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së dytë të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Pika e dytë

Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016;

Sami Hamiti tha se është dashur të jenë prezentë këtu kryetari, nënkryetari dhe drejtori i financave, se janë pika të rëndësishme dhe është obligim të trajtohen në këtë KPF se është e përcaktuar me ligj. Sa i përket bartjes së buxhetit unë shohë shumat të cilat nuk përputhen, bartja pavarësisht a është donacione dhe participime nuk figurojnë, nuk janë ku janë mbetur, pjesa e donacioneve nuk ekziston.

Prej përvojës po them bartja e mjeteve prej vitit në vite bëhet sipas kodeve të projekteve shumë mirë ka qenë tash një vit. Unë nuk e di pse është bërë kaq formale tash kur që ne e kemi pasur një debate dhe kanë qenë të gjitha projektet dhe të hyrat kanë qenë të vendosura në shifra dhe kode dhe është ditur sa janë të lira.

Te investimet kapitale, çështjen e projekteve apo mjeteve të lira, nuk po flasim për mjete të zotuara unë e di shumica absolute e tyre janë të zotuara, mirëpo është mirë të figurojnë cilat janë sepse atë drejtë mi bartë mi caktuar në pika e ka vetëm Kuvendi.

Qëndron Kastrati tha se fatkeqësisht prej kolegëve tonë i ka ra rëndësia e këtij komiteti, ku një pjesë e përfaqësuesve nuk i paraqesin qëndrimet e tyre e në fund thonë në Kuvend i paraqesim qëndrimet tona, cila është rëndësia e këtij Komiteti.

Në raport me pikat ne jemi dakord, se janë çështje të kontraktuara por për shkaqe të ndryshme nuk kanë mundur të përfundohen në vitin 2015 dhe vetëm kanë vazhduar në vitin 2016.

Kryesuesi tha se nuk ka ra interesimi i Komitetit për Politikë dhe Financa, së pari ekzekutivi duhet të jetë me kohë e sidomos kurë është fjala për çështjen e buxheteve. Ne si anëtarë të komitetit si Kuvend pa ekzekutivin nuk mund të bëjmë asgjë.

Lirak Çelaj tha se disa herë e kam shpreh shqetësimin tim për funksionimin e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe këtë kritikë, vërejtje e kam adresuar te ju kryesues, se nuk është marrë parasysh mendimi i shumicës në komitet për tu përpiluar rendi i ditës në Kuvend.

Unë mendoj se ju keni at mundësi të përfillni, mbështesni qëndrimin e komitetit kur e përpiloni rendin e ditës. Insistojnë në interpretimin e rregullores e cila thotë rendin e ditës e përpilon kryesuesi në konsultim me Kryetarin. Ju jeni përgjegjës për rendin e ditës që na vjen neve aty, ekzekutivi ka të drejtë të bie kërkesa dhe ne i trajtojmë.

Sa i përket pikës në rend unë kamë dy propozime që na kanë ardhur, dy kërkesa prej dy ndërmarrjeve publike për të cilat është mirë të ndahet një buxhet i caktuar për këto dy ndërmarrje publike.

1.Për ndërmarrjen publike „Termokos”kur është bërë projekti i kogjenerimit është dashur të bëhet një shpronësim i tokës për vendosjen e gypave. Me kontratë „Termokosi “ e ka përgjegjësin, mirëpo është mirë një pjesë të kësaj shume t’ia ndihmojmë kësaj ndërmarrje

2.Në vitin e kaluar Pishina e Gërmisë nuk ka funksionuar se ka qenë duke u rikonstruktuar dhe punëtorët është dashur të paguhen dhe gjithë kjo e ka dërguar ndërmarrjen në minus.

Është ende në borxhe se nuk ka pasur të hyra për shkak se Pishina pa fajin e ndërmarrjes është dashur të jetë e mbyllur për shkak të renovimeve. Ata kanë sjell një kërkesë nëse nuk gaboju janë afër 86.000 €, ti ndihmojmë që kjo ndërmarrje të jetë më e qëndrueshme.

Mirlinda Sopi tha se sa i përket mjeteve të bartura unë mendoj se mjetet që nuk kanë mundur të shfrytëzohen në vitin 2015 po bartën në vitin 2016 është në rregulle.

Brahim Mehmetaj tha se nëse ky Komiteti për Politikë dhe Financa e konsideron veten si shkallën më të parë të përgatitjes së mbledhjes të Asamblesë Komunale unë mendoj ti themi vetvetes dhe kolegëve të jemi më të ndërgjegjshëm që kur të vijmë në seancë të dalim serioz para qytetarëve siç nuk ka ndodhur deri tash.

Sa i përket bartjes së buxhetit e përkrahi.

Dardan Sejdiu tha se, sa i përket vërejtjeve të bëra nga z.Hamiti unë dakordohem me z.Kokaj, do ti trajtojmë dhe se është e vërtetë se vitin e kaluar ka qenë e përgatitur më saktë edhe këtë vit do ta bëjmë ashtu.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Propozimvendimi për bartjen e buxhetit të pashpenzuar nga viti 2015 në vitin 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Pika e tretë

Raporti tremujor janar - mars 2016

Dardan Sejdiu, lidhur me Raportin tremujor janar-mars 2016 tha se është raport i përgatitur nga kryetari i Komunës, është në pajtim me dispozitat ligjore në Kuvendin Komunal dhe do të trajtohet nga të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Ajo që është njëra prej sfidave kryesore që do të ballafaqohemi sivjet janë të hyrat vetanake. Është sfidë me të cilën gjithësesi jemi të vet dijsëm me të cilën përballohem. Nuk është dukuri vetëm në Komunën e Prishtinës nuk po e them si arsyetim por e them si konstatim, por gjithsesi raporti i parë tre mujor e shpërfaq më së shumti këtë. Po besoj të gjitha tjerat janë të përfshira në raport.

Sami Hamiti tha se sfidat kryesore janë inkasimet e të hyrave vetanake. Duhet të shikohet të punohet më shumë sepse nëse shikoni tri vitet e fundit në tre mujorin e parë kemi ramje, jemi më pak se në vitin 2015, më pak ka qenë në vitin 2015 se në vitin 2014 ka qenë një trend që ka ra.

Ai tha se nëse e keni procesverbalin e mbledhjes të Komitetit për raportin vjetor kam bërë disa vërejtje, sugjerime të cilat nuk janë përmirësuar, as një tabelë nuk është përmirësuar. Unë ju pata thënë merrni shikoni e përmirësoni mirëpo në Kuvend na ka ardhur materiali i pa përmirësuar. Merrni shikoni asnjë tabelë, prej të hyrave përqindjeve, investimeve kapitale nuk ju barazohet.

Qëndron Kastrati, për mua ky është raport që vetëm na shpjegon gjendjen dhe politikisht secili këshilltarë mund të paraqet rekomandimet, sugjerimet, kritikën e tij. Nuk jam vetëm me tentuar a po arrin me realizuar planifikime dhe me tentuar vetëm me siguruar më shumë të hyra. Për mua më primare është cilësia se inkasim mjetesh, nuk jam me lëshuar dorë të dhënja e lejeve në urbanizëm apo cilëndo qoftë. Për mua personalisht si rekomandim nuk e kisha marrë në raport vetëm zbatimet e realizimit të planifikimit, por kisha tentuar edhe cilësinë e shërbimeve dhe gjithë ato që janë kompetencë e Komunës me qenë ma funksionale.

Lirak Çelaj tha se te pikat në Drejtorinë e investimeve kapitale dhe menaxhimit të kontratave në kurë e kemi aprovuar buxhetin këto shuma d.m.th pikat 1 dhe 2 ndërtimi i rrugëve në pjesë urbane me infrastrukturë përcjellëse dhe ndërtimi i rrugëve në pjesën rurale me infrastrukturë përcjellëse që qenka 2miljon euro i patëm zbërthyer në projekte specifike dhe patëm aprovuar një listë të projekteve dhe rrugëve. Unë mendoj që ajo duhet të mos figuron si e tillë në raport, por duhet të zërthehet ashtu siç e kemi aprovuar buxhetin.

Brahim Mehmetaj shprehi shqetësim për çështjen e legalizimit të ndërtimeve që është një temë e ndjeshme për qytetarët e Prishtinës. Kisha kërkuar me përdorë autoritetin edhe si ekzekutues dhe si Asamble Komonale që ato procedura byrokratike që janë për legalizim mi thjeshtësuar me bërë presion te Ministria përkatëse që merret me këto çështje se këtu është problemi se nuk është problemi se qytetarët nuk po dëshirojnë mi legalizuar ndërtimet.

Lirak Çelaj tha se po më intereson për propozimin për pikën dy a do të inkorporohet në këtë bartje të buxhetit apo jo dhe është mirë të marrim një qëndrim si komitet e Kuvendi vendos.

Kryesuesi tha do të bisedojmë me Kryetarin se është çështje financiare, në parim është mirë me hyrë në Kuvend nëse ka mundësi.

Dardan Sejdiu tha se atë që e tha z. Mehmetaj ne si ekzekutiv e bëjmë gati çdo ditë me Ministrinë, drejtoritë tona gjithashtu edhe Kryetari çdo ditë me Ministrinë komunikojmë për temën e legalizimit për shkak të ndryshimeve që duhet të bëhen në ligj.

Unë pajtohem me juve nuk është keq që Kuvendi Komunal, asamblistët e Kuvendit Komunal të nxjerrin një deklaram, rekomandim i cili është një iniciativë për të lehtësuar edhe qytetarët, sepse legalizimi mundëson ata që të kenë diçka në dorë me të cilin mundë të ndërtojnë vlerë shtesë për vete dhe familjen e tyre.

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u përkrah Raporti tremujor janar - mars 2016 dhe i dërgohet Kuvendit për shqyrtim.

Të ndryshme

Brahim Mehmetaj ngriti çështjen që ka të bëjë me pagesën e anëtarëve të Kuvendit duke kërkuar nga kryesuesi që të jetë më i kujdesshëm ndaj asamblastëve, në raport me mbledhjet e Kuvendit dhe për mos pagesën e tyre. Ai shtoi se kryesuesi me veprimin e tij nuk ka pasur të drejtën që e ka ndalë pagesën për asamblastëve, pa pasur kur farë vendimi kundër këtij procesi. Po ashtu tha të gjinden hapësira buxhetore që kjo lloj page të rritet ose forma tjetër të përkrahet aktiviteti i asamblastëve.

Kryesuesi tha se nuk varet prej kryesuesit, nuk varet prej Kuvendit. Është rregullorja për pagesën e stafit në komunë dhe stafit politikë. Mbledhja që nuk mbahet, për mbledhje që nuk mbahet i humb 125 € ai që nuk nënshkruhet. Unë kam kontaktuar me MPL-në dhe ju kam treguar në Kuvend, se mbledhja që nuk mbahet nuk paguhet. Ne me drejtorin e administratës ja kemi dërguar një shkresë MPL-së, dhe nëse marrin ndonjë konfirmim për pagesë, ne do ti paguajmë

Sami Hamiti dha sqarime lidhur me këtë çështje.

Qëndron Kastrati tha se kryesuesi nuk është duke vepruar si kryesues i të gjithë asamblastëve, mendoj se është i një anshëm. Ai ju drejtua kryesuesit duke cekur se: “Nuk ki të drejtë me ja mohuar një asamblasti me ngrit një pikë të rendit të ditës dhe kjo është tu prodhuar situata ku kanë filluar ofendime shumë të rënda”. Në një mbledhje z.Hamiti ka bërë disa ofendime shumë të rënda. Po them se përgjegjësia kalon mbi juve, të lutem mundoheni të jeni më korrektë. Po ashtu edhe prej anës sonë ka pasur një sjellje të tillë ku një këshilltarë e ka ofenduar një asamblastë tjetër.

I lutem z.Sami të mos përsëriten ato se përgjegjësia është bie mbi ty.

Mbledhja përfundoi në orën 16:10.

Procesmbajtësja:
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Halim Halimi, jur. i dipl.